



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	12.10.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Besim MULAJ U.d. Menaxher i zyrës së Prokurimit në Komunën e Pejës
CC:	z. Gazmend MUHAXHERI Kryetar i Komunës së Pejës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin " Servisimi, Riparimi dhe ndërrimi i pjesëve të automjeteve dhe gjeneratorëve në Komunën e Pejës"



I nderuari z. Mulaj,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksonit Publik, lidhur me tenderin " Servisimi, Riparimi dhe ndërrimi i pjesëve të automjeteve dhe gjeneratorëve në Komunën e Pejës" me numër prokurimi: 16319 15 112 211, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohej nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " Servisimi, Riparimi dhe ndërrimi i pjesëve të automjeteve dhe gjeneratorëve në Komunën e Pejës" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit në Komunën e Pejës ka përgatitë Njoftimin për Kontratë me titull " **Servisimi, Riparimi dhe ndërrimi i pjesëve të automjeteve dhe gjeneratorëve në Komunën e Pejës**" me numër prokurimi: 16319 15 112 211, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt. 30.09.2015, në Procedurë të Hapur. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë prokurimi si rast për trajtim. Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit të kësaj procedure të prokurimit, Agjencia Kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Pejës ka parapa për që përmes këtij aktiviteti të prokurimi të bëjë lidhjen e një kontrate Publike Kornizë për 36 muaj, ku në këtë kontratë ka parapa servisimin dhe riparimin e automjeteve njëkohësisht edhe të gjeneratorëve..

Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes specifikimet teknike që janë përpiluar për këtë tender ka konstatuar se në pjesën e specifikimeve teknike Autoriteti Kontraktues nuk ka parapa një sasi të përafërt të punëve dhe furnizimeve që do të realizohen në këtë aktivitet të prokurimit. AKK gjatë shfletimit të Dosjes së Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit ka vërejtur se Tek pjesa Seksioni II. Fleta e të dhënave të Tenderit (FTD) të dosjes së tenderit tek rubrika 2.1-Qëllimi i Kontratës, Autoriteti Kontraktues ka përshkruar sasinë si në vijim: *Qëllimi i kontratës është që të përcaktohen kushtet që rregullojnë kryerjen e shërbimeve në vijim: Sasia e përafërt për 36 muaj për servisim është 12 automjete të Administratës, 13 automjete të NJPZSH, dhe 8 automjete të Drejtoratit të Shëndetësisë dhe disa gjenerator.*

Agjencia konsideron se një përshkrimi i tillë është vetëm një tregues që përcakton numrin e automjeteve që do të servisohen, por kjo assesi nuk mund të jetë një tregues për vlerën e përafërt të kontratës. Bazuar në Rregulloren për Prokurim Publik Autoriteti Kontraktues duhet të specifikoj sasinë gjatë përgatitjes së materialit tenderues, po ashtu në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasia mund të mos jenë të parashikuara në mënyrë precize, duhet të bëhet një parashikim i përafërt i sasive. E jo si në rastin e Autoritetit Kontraktues ku përveç përshkrimit të llojit të automjeteve që do të servisohen si dhe llojit të pjesëve të cilat do të servisohen-furnizohen nuk ka asnjë përshkrim tjetër, sasia është e pa definuar.

Agjencia Kundër Korrupsionit pasi ka analizuar me kujdes pjesën e specifikimeve teknike për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues në disa pozicione të specifikimeve teknike ka paraparë edhe pozicione që kanë të bëjnë me larjen e veturave si dhe pozicione tjera që kanë të bëjnë me servisimin e gjeneratorëve. AKK konsideron se natyra e tillë e shërbimeve kërkon zhvillim të aktiviteteve të ndara pasi që për kryerjen e këtyre furnizimeve dhe shërbimeve nevojiten Operatorë Ekonomik të profileve përkatëse.

Kjo ndërlidhet edhe me faktin se hartimi Kërkesave minimale për kualifikim (përshtatshmëria, profesionaliteti, kërkesat teknike dhe financiare) si dhe kriteret për dhënie të kontratës duhet përpiluar në pajtueshmëri me natyrën e aktivitetit të prokurimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 si dhe nenin 9 Funkcionet e Njësisë së Kërkesës të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe të shmangen praktika të tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt!